

VENDIM
Nr.267, datë 28.4.2005

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES, PËR SHPENZIMET E KRYERA PËR PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE NGA RESHJET E BORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19, 20, shkronja “a”, e 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, zëri “Mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për shpenzimet e kryera për përballimin e situatës së krijuar nga reshjet e borës.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano